A.K.P.A.
Nr 2777 Prot.
Datë,më 20.10.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA PROFESIONALE TEKNIKE KORÇË

Nr.559 Prot. Korçë, më 15 / 10 /2026

Lënda : Njoftim për vend të lirë

DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", i ndryshuar.

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 "Për nxitjen e Punësimit", Ligjit nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë",i ndryshuar, , Udhëzimit Nr 759, datë 30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit",i ndryshuar.

Ofruesi publik i AFP-së Shkolla Profesionale Teknike Korçë, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin:

- **Instruktori i praktikës profesionale për drejtimin Mekanik , me kohë të pjesshme – 2 person**

- **Instruktori i praktikës profesionale për drejtimin Termohidraulikë , me kohë të pjesshme – 1 person**

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme për instruktor i praktikave profesionale për drejtimin Shërbimesh mjetesh transporti, me kohë të pjesshme.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;

d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

a) të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale, pas të mesme ose parauniversitare në të njëjtën fushë me kualifikimin/kualifikimet profesionale për të cilin/cilat po aplikon;
b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet ;
c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacion e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:
a) letërmotivimin për pozicionin;
b) jetëshkrimin (CV-në);
c) kartën e identitetit;
d) diplomën;
e) librezën e punës;
f) çdo dokument tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
g) certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
h) vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
i) vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
j) vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënës të mëparshëm.
Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara.
Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyera dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës 27.10.2026

3. Vlerësimi i kandidatëve do bëhet referuar përcaktimeve të Udhëzimit nr. 759, datë 30.09.2024,

"Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", i ndryshuar.

Drejtor

Anxhela TAHO

Adresa: Rruga" Bulevardi Rilindasit" Lagjia 10 Tel : 082243076 e-mail shkollateknikekorce@gmail.com